

**STATUT**  
**I**  
**SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**“ SALEH“ SHPK**

Sot ne date 07/07/2015 ( Shtate Korrik Dymije e pesembedhjete) ne qytetin e Korces duke u bazuar ne vullnetin e tij te lire, te plote dhe te sinqerte dhe ne mirekuptim te ndersjellte, ne baze te ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 “ Per tregtaret dhe shoqerite tregtare “ ortaku:

**Alfhiad Saleh Abdulrahman A** i biri i **Abdulrahman** i lindur me 28 Nentor 1962 ne qytetin Bukyria, shtetas i Mbretetise Arabise Saudite identifikuar nga pasaporta me nr. K712790.

**Dritan Bilbili** i biri i **Albert** i lindur me 11 Dhjetor 1978 ne Korce, banues ne Korce, shtetas i Shqiptar identifikuar nga karta e identitetit me nr. 030597357.

Kane hartuar kete statut lidhur me organizimin, administrimin dhe drejtimin e shoqerise tregtare “ **SALEH** “ **Sh.p.k** .

Shoqeria eshte “ Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar” ku ortaket mbulojne personalisht humbjet e shoqerise deri ne pjesen e pashlyer te kontributeve te nenshkruara.

Kontributi i ortakeve perbejne kapitalin e regjistruar te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar. Prezent ne hartimin e ketij statuti eshte dhe nje perkthyes i gjuhes Arabe, meqenese njeri nga ortaket eshte shtetas i Arabise Saudite .

**NENI 1**

**Emërtimi i shoqërise**

Shoqëria tregtare do te mbaje emrin “ **SALEH** “ **Sh.p.k** i cili do te jete i stamposur dhe ne vulën e saj dhe do te figuroje ne te gjitha aktet ose dokumentat e nxjera nga shoqeria dhe qe ju drejtohen te treteve. Per marredheniet e saj me subjekte jashte territorit te Shqiperise, shoqeria do te mbaje te njejtin emërtim me gërma latine.

**NENI 2**

**Selia e shoqerise**

Selia e shoqerise eshte ne qytetin e Korces, ne adresen : Rruga Ajet Xhindolli nr. 2. Lagja nr 8 , Korce. Shoqeria mund te krijoje dege dhe filiale ne rrethe te tjera te Shqiperise dhe jashte saj.

**NENI 3**

Shoqeria tregtare “ **SALEH** “ **Sh.p.k** eshte subjekt juridik Shqiptar dhe veprimtarine e saj e bazon ne legjislaturen shqiptare dhe kryesisht ne :

- Ligjin nr. 9901 date 14.04.2008 „Per tregtaret dhe shoqerite tregtare“

**NENI 4**

**Kohezgjatja e shoqerise**

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise do te jete mbi 20 vjet. Kohezgjatje e cila nis ne momentin qe ajo regjistrohet ne regjistrin tregtar prane QKR.

**NENI 5**

Personalitetin e saj ligjor Shoqeria e fiton nepermjet Vendimit te regjistrimit prane QKR.



## NENI 6 Objekti i shoqerise

Objekti i veprimtarise ekonomike dhe qellimi i shoqerise eshte :

Aktivitet tregtar ne fushen e prodhimit bujqesor dhe ne marketing duke patur te drejte te prodhojne, te manipulojne, te perpunojne, te ruajne, te klasifikojne, te transportojne, te shperndajne, si dhe te tregtojne produktet bujqesore ose blegtorale ne gjendjen e tyre natyrale ose te perpunuar me pare.

Import Eksport, Tregtim me shumice i kafsheve te gjalla

Import , Blerje nga vendi , eksport perpunimi i lekures net –blu dhe pikilat.

Grumbullim, seleksionim, perpunim deri ne produkt te gatshem i te gjitha llojeve te lekures dhe i derivateve apo nenprodukteve te saj, eksportim dhe importim i saj si dhe i kimikateve te ndryshem te lidhura me procesin teknologjik, import, eksport leshi e artukuj te ndryshem industrialë.

Tregeti me pakice dhe shumice te lekureve dhe prodhimeve te tjera kimike e jo kimike per prodhimin e saj.

Shitblerje me shumice e pakice dhe eksport import i mallrave te ndryshme ushqimore, industriale, materiale te ndertimit, lende te para, gjysem fabrikate, makineri paisje makineri dhe pjese ndertimi per to.

Investime dhe pjesemarrje ne investime dhe shoqeri te tjera shqiptare dhe te huaja ne fusha te ndryshme si: industri, ndertim, bujqesi, transport, hoteleri, turizem etj.

Aktivitet prodhues ne fushen e prodhimit te drurit dhe nenprodukteve te tij, pelete, dru zjari etj.

Prodhimi i te gjitha llojeve te parketit, karrigeve, dyerve, mobilje.

Grumbullim e perpunim i produkteve bujqesore dhe blektorale, bimeve medicinale e prodhimeve te pyllit, mbareshtimin e pyjeve, pyllzime, permiresime pyjeore, sistemime malore, shfrytezim pyjesh, mbareshtimin e kullotave dhe livadheve.

Prodhim i materialit te qeramikes produkteve dhe nenprodukteve te saj si: tjegulla, tulla tubacione qeramike, drenazhimi, etj.

Tregtimi me shumice e pakice i produkteve te siperpermendura brenda dhe jashte vendit, duke u perfshire ne veprimtari eksport-importi, transporti i produkteve te mesiperme si dhe i lendes se pare etj.

Shfrytezimin e karrierave te gurit dhe shitjen e materialeve te nxjerra. Shfrytezim mineral grupi 4.

Prodhime artizanale prej guri e mermeri, shitja e montimi i tyre.

Prodhime industriale prej guri e mermeri, shitja e montimi i tyre.

Fraksioni i materialeve inerte prej guri e mermeri, shitja e montimi i tyre.

Prodhim e shitje elemente prej betoni dhe parafabrikate prej betonarmeje.

Prodhim asfalti

Prodhim e shitje betoni.

Prodhim e shitje gelqere.

Perdorim dhe transportim i lendeve djegese,

Ndertimi dhe projektimi i ndertimit, projekte per objekte social-kulturore, banesash, objekte industriale dhe bujqesore, hidroteknike, rruges, urash, punime gjeodezike, projekte konstruksionesh, pershtatje dhe kikonstruksione te ndryshme, vepra arti, qe lidhen me to. Projektim dhe ndertim termocentrale, hidrocentrale, vepra hidrike, stacione, nenstacione elektrike, prodhim, shitje energji elektrike.

Perpunimi i materialeve plastike dhe duralumini.

Hapje lavazho, servis si dhe tregtim pjese kembimi

Aktivitet ne fushen e turizmit dhe hotelerise .

## NENI 7 Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise ka vleren 100 000 leke i ndare ne 2 kuote me vlere secila prej 50 000 lek.

Secili nga ortaket zoteron nga 1 kuote si me poshte :

**Alfehiad Saleh Abdulrahman A** zoteron 1 kuote ne masen 50% te kapitalit themeltar ne vleren 50 000 lek

**Dritan Bilbili** zoteron 1 kuote ne masen 50% te kapitalit themeltar, ne vleren 50 000 lek

Zvogelimi i kapitalit themeltar ne nje shume me te vogel se shuma minimale e parashikuar nga ligji e detyron shoqerine ta plotesoje ate, perndryshe ajo do te shndrohet ne nje forme tjeter ose te prishet.

Kontributet ne sherbime nuk mund te shperblehen me pjese ne kapitalin themeltar.

Ne kushtet kur shoqeria eshte e perbere nga nje ortak i vetem ky element regjistrohet ne QKR sipa nenit 43 te ligjit nr. 9723 date 3.5.2007 „Per qendren kombetare te regjistrimit“ te ndryshuar.

## NENI 8

Ndalohet emetimi i letrave me vlere nga Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar. Po qe se behet nje gje e tille, ky emetim eshte i pavlefshem.

## NENI 9

### Kuotat e Kapitalit

Transferimet e kuotave te kapitalit duhet te vertetohet me akt noterial. Ato mund te fitohen apo kalohen nepermjet shitblerjes, dhurimit, me rruge trashegimnie ose me cdo menyre tjeter te parashikuar ne ligj.

Ne qofte se pjeset qe transferohen perbejne pasuri te perbashket, bashkeshorti i transferusit duhet te jape pelqimin e tij.

Pjeset e kapitalit themeltar mund t'u transferohen personave te trete qe nuk bejne pjese ne shoqeri. Ne kete rast transferimi duhet te jete i miratuar nga ortaket ne kushtet e shumices se kerkuar per ndryshimet ne statut (shumica qe perben  $\frac{3}{4}$  e pjeseve te kapitalit themeltar).

Perfituesit qe perfitojne nga transferimi detyrohen te disponojne kapitalin e perfituar per nevojat e shoqerise, duke mare persiper te gjitha te drejtat dhe detyrimet qe kishte mbajtesi i kapitalit. Transferimet ndermjet ortakeve kryhen lirisht. Ndryshimet ne pjeseve te kapitalit themeltar duhen te pasqyrohen ne statut dhe ne QKR.

## NENI 10

### Zmadhimi i kapitalit

Zmadhimi i kapitalit vendoset me shumicen e parashikuar per ndryshimet e statutit ( $\frac{3}{4}$  e pjeseve).

Zmadhimi i kapitalit me ane te nenshkrimeve te pjeseve te kapitalit themeltar per kontributet ne para behet duke depozituar per llogari te shoqerise ne nje banke fondet ne para.

Pjeset e reja te kapitalit themeltar mund te nenshkruben qofte nga ortake ekzistues qofte nga persona jo ortake.

Zmadhimi i kapitalit mund te behet nepermjet perfshirjes ne te te rezervave te lira, te fitimeve te pashperndara.

Zmadhimi i kapitalit plotesisht ose pjeserisht me ane te kontributeve ne natyre behet ne baze te nje raporti te ekspertit kontabel i emeruar sipas legjislacionit shqiptar.

Kur pjese te reja te kapitalit themeltar nenshkruhen nga persona joortak keta duhen te miratohet nga shumica e ortakeve qe perfaqesojne  $\frac{3}{4}$  e ortakeve.

## NENI 11

### Zvogelimi i kapitalit

Zvogelimi i kapitalit duhet te autorizohet nga asamblea e ortakeve e cila merr vendim te shumices se ortakeve qe perfaqesojne  $\frac{3}{4}$  e ortakeve.

Realizimi i zvogelimi te kapitalit mund te arihet nepermjet zvogelimi i vleres nominale te pjeseve ose zvogelimi i numrit te pjeseve.

Kapitali themeltar nuk mund te zvogelohet ne nje shume me te vogel se minimumi ligjor.

## NENI 12

### Asamblea e Pergjithshme

Organi vendimares i shoqerise eshte asamblea e pergjithshme

Asamblea e pergjithshme thiret nga administratori.

Thirja e asamblese behet me shkrese e cila duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites dhe dergohet me leter rekomande te pakten 7 dite perpara mbledhjes se asamblese.

Cdo mbledhje e thirur ne menyre te parregullt mund te anulohet.

1. Asambleja e pergjithshme eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per cheshtjet e meposhtme:

- a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emelimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emelimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te ekspertëve kontabel te autorizuar;
- d) percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat "c" dhe "ç" te kesaj pike;
- dh) mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- ë) zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
- f) pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) perfaqesimin e shoqerise ne gjykatë dhe ne procedimet e tjera ndaj dministratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
- h) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblesë;
- i) cheshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.

2. Asambleja e pergjithshme merr vendime per cheshtjet e percaktuara ne shkronjat "e" dhe "ë" te pikës 1 te ketij neni, pas marrjes dhe shqyrtimit te dokumenteve perkates.

3. Nese shoqeria zoterohet nga nje ortak, te drejtat dhe detyrimet e asamblesë se pergjithshme ushtrohen nga ortaku i vetem. Te gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetem regjistrohen ne nje regjister te vendimeve, te dhënat e te cilit nuk mund te ndryshohen ose te fshihen. Duhet regjistruar ne veçanti, por pa u kufizuar ne to, vendimet per:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- b) shperndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet per riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Vendimet e paregjistruara ne regjistrin e vendimeve jane absolutisht te pavlefshme. Shoqeria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmerine te tretit, qe ka fituar te drejta ne mirebesim, pervec rastit kur shoqeria provon se i treti ka pasur dijeni per pavlefshmerine, apo ne baze te

rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.  
Ndryshimet ne statut vendosen nga ortakët qe perfaqesojne te pakten ¾ e pjeseve te kapitalit themeltar.

### **NENI 13**

#### **Kuorumi**

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 87 të ligjit 9901 date 14.04.2008, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të ligjit 9901 date 14.04.2008.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

### **NENI 14**

#### **Marrja e vendimeve**

Me përjashtim të rasteve kur statuti parashikon një shumicë më të lartë, asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, siç përcaktohet në pikën 1 të nenit 86 ligjit 9901 date 14.04.2008, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj ose në statut, për çështjet e tjera të renditura në nenin 81 të ligjit 9901 date 14.04.2008, asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj, vlefshmëria e vendimeve, që përcaktojnë detyrime shtesë mbi ortakët, apo vendimet që kufizojnë të drejtat e tyre, të parashikuara në këtë ligj ose në statut, kushtëzohet nga miratimi i ortakut përkatës.

### **NENI 15**

#### **Procesverbalet e mbledhjes së asamblesë**

Të gjitha vendimet e asamblesë së përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratorët përgjigjen për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të asamblesë së përgjithshme.

Procesverbali duhet të përmbajë datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit.

Procesverbalit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si edhe akti i thirrjes së asamblesë së përgjithshme.

Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.

### **NENI 16**

#### **Administrimi**

Administratori është perfaqesuesi ligjor i shoqërisë ndaj te treteve.

Ai ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne mardhenie me te tretet ne emer te shoqërisë, ne te gjitha rethanat.

Shoqëria tregtare "SALEH" Sh.p.k administrohet nga nje person fizik..

Administrator i Shoqërisë Tregtare "SALEH" Sh.p.k është **Dritan Bilbili** i biri i Albert i lindur me 11 Dhjetor 1978 ne Korce, banues ne Korce, shtetas i Shqiptar identifikuar nga karta e identitetit me nr. 030597357 i cili do te perfaqesoje shoqerine ne te gjithë veprimtarine e saj.

Administratori emerohet per nje periudhe 5 (pese) vjecare me te drejte ripertesitje.

Administratori mund te shkarkohet nga asamblea me shumice te zakonshme.

Administratori kryen te gjitha veprimet e administrimit ne interes te shoqerise.

Te gjitha vendimet qe ai merr duhet te jene ne pajtim me interesin e siper marrjes

Administratori ka keto kompetenca :

- Kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- Përfaqësojnë shoqërinë tregtare ne maredhenie me te tretet;
- Kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- Përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim
- Krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- Kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- Raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- Siguron zbatimin e vendimeve qe jep asamblea e pergjithshme.
- Propozon krijimin e organeve te reja per permiresimin e punes.
- Nenshkruan per llogari te shoqerise kontrata.
- Lidhen kontratat individuale dhe ato kolektive te punes.
- Kryen cdo detyre tjeter te percaktuar ne ligjin „Per tregtaret dhe shoqerite tregtare“ dhe ne statut.

Shoqeria merr persiper detyrimet qe rrjedhin nga aktet e administratoreve edhe kur ato nuk perfshiheshin ne objektin e shoqerise.

Shoqeria nuk merr persiper pasojat ndaj te treteve kur ajo provon se te tretet e dinin qe aktet e administratoreve e kalonin objektin e shoqerise.

Administratori nuk mund te behet dorezanes apo te garantoje ne emer te saj angazhimet ndaj te treteve.

Administratori mund te shkarkohet me vendim te asamblese se pergjithshme.

Administratori mund te delegoje kompetenca te vecanta por nuk mund te delegoje teresine e kompetencave te tij.

Administratoret jane pergjegjes individualisht ndaj shoqerise ose te treteve per shkelje ligjore, per shkeljen e ketij statuti , per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.

Administratori ka detyrimin e besnikerise ndaj shoqerise.

#### NENI 17

#### Eksperteti Kontabel

Asamblea e ortakeve cakton ekspert kontabel per nje periudhe prej 2 vite financiare.

Emerimi i ekspertit behet nga asamblea e pergjithshme. Gjithashtu ai emerohet dhe nje zvendes ekspert kontabel ne rast te mos pranimit, pengimit doreheqje ose vdekje te ekspertit kontabel.

Eksperti kontabel zgjidhet nga nje liste e hartuar nga organizimi profesional i eksperteve kontabil.

Nuk mund te jene eksperte kontabil administratoret e shoqerise si dhe paraardhesit dhe pasardhesit, bashkeshortet e tyre ,themeluesit si dhe personat e afert deri ne shkallen e katert. Eksperti kontabel mund te jape doreheqjen per arsye personale.

*Eksperti kontabel ka per detyre te :*

- Kontrollloje vlerat dhe dokumentet kontabel te shoqerise
- Te kontrollloje pajtushmerine e kontabilitetit te shoqerise me legjislacionin ne fuqi.
- Te verifikojte perputhjen me llogarite vjetore.

Eksperti kontabel nuk duhet te perzihet ne drejtimin apo administrimin e shoqerise.

*Eksperti kontabel duhet te informoje administratorin per:*

- Kontrolllet dhe verifikimet qe jane kryer.
- Verejtjet per ndryshime qe sipas tyre u duhen bere bilancit dhe dokumentit kontabel.
- Paregullsite dhe pasaktesite qe jane zbuluar

*Eksperti kontabel duhet te informoje asamblene e ortakeve per:*

- Nje raport te pergjithshem per verifikimet dhe kontrolltet e kerkuara nga ligji.
- Verejtjet per llogarite vjetore.
- Raport per zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit themeltar.

Eksperti kontabel mban pergjegjesi per shqyrtimin e llogarive dhe rregullshmerine e tyre.

Eksperti kontabel eshte pergjegjes si ndaj shoqerise ashtu edhe ndaj paleve te treta per pasojat e demshme qe rrjedhin nga fajet dhe nenvlefesimet e tyre gjate ushtrimit te funksioneve perkatese.

## NENI 18

### Viti financiar

Rezultatet e veprimtarise te cdo shoqerie tregtare vleresohen periodikisht ne fund te cdo viti financiar.

Kohezgjatja e vitit financiar eshte 12 muaj dhe perputhet me vitin kalendaristik.

Per te pasur llogari vjetore qe te pasqyrojne realisht pasurine dhe gjendjen financiare, shoqeria duhet te :

- Mbaje nje kontabilitet te rregullt ne perputhje me kerkesat e ligjit.
- Te kontrollloje me inventar ekzistencen dhe vleren e pasurise ne mbyllje te vitit financiar

## NENI 19

### Fitimi

Fitimi qe do te shperndahet perbehet nga fitimi i vitit financiar, te cilit i jane zbritur ose jane shtuar respektivisht humbjet apo fitimet e mbartura nga vitet e meparshme.

## NENI 20

### Dividentet

Asamblea e pergjithshme mund te vendose shperndarjen e dividenteve vetem pasi:

- Te kete miratuar llogarite vjetore
- Te kete percaktuar shumen qe do te ndahet.

Cdo dividend i shperndare duke shkelur keto rregulla, perben nje dividend fiktiv.

## NENI 21

### Shnderrimi, Bashkimi dhe Likujdimi

Shnderrimi i shoqerise nga SHPK ne Shoqeri anonime behet me vendimin e  $\frac{3}{4}$  te ortakeve sipas kushteve te percaktuara ne ligj.

Shoqeria mund te bashkohet me shoqeri te tjera me vendim te Asamblese e Pergjithshme.

Një shoqëri mund të riorganizohet nëpërmjet bashkimit me një shoqëri tjetër, nëpërmjet ndarjes në dy apo më shumë shoqëri të tjera ose nëpërmjet shndërrimit të formës ligjore. Shoqëritë mund të riorganizohen vetëm pasi kanë qenë të regjistruara për të paktën një vit. Bashkimi i shoqërive kryhet në përputhje me dispozitat për mbrojtjen e konkurrencës. Shoqëria është në likuidim e sipër nga momenti i prishjes së saj për çdo lloj shkak përveç rastit kur kemi të bëjmë me bashkimin e pjeseve të kapitalit. Kur vendoset prishja e shoqërisë, asambleja e përgjithshme cakton likuidatorin, akti i cili regjistrohet në regjistrin tregtar pranë QKR. Aktet e likuidimit së bashku me llogaritë perfundimtare depozitohen në regjistrin tregtar pranë QKR. Mbas mbylljes së likuidimit dhe depozitimit të dokumentave në regjistrin tregtar, shoqëria rregjistrohet prej tij. Likuidatori është përgjegjës si ndaj shoqërisë ashtu edhe ndaj paleve të treta për pasojat e demshme që rrjedhin nga fajet dhe nenvleftesimet e tyre gjatë ushtrimit të funksioneve përkatëse.

## NENI 22


Ky statut i Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar u hartua në 4 kopje, në gjuhën shqipe dhe nënshkruhet me dëshirën e ortakëve të shoqërisë duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën origjinale në të gjitha kopjet e tij.

## ORTAKET E SHOQËRISË TREGTARE

Alfeliad Saleh Abdulrahman A



Dritan Bilbili



Perkthyes

Nasimic Agullli

